



BASHKIA
TIRANË

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomik "EVEREST" shpk & "SHANSI INVEST" shpk

Adresa: Kamëz, Fabrika në Rrugën Nacionale, pranë Nyjes së Betonit

TIRANË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: **"Rikonstruksion i pjesshëm i shkollës së mesme të përgjithshme "Andon Z. Çajupi"**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Rikonstruksion i pjesshëm i shkollës së mesme të përgjithshme "Andon Z. Çajupi"**, duke realizuar rikonstruksionin e pjesshëm të shkollës së mesme të përgjithshme "Andon Z. Çajupi", sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit

Fondi limit: **123.503.662** (njëqind e njëzet e tre milion e pesëqind e tre mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH**

Burimi i financimit: Vënë në dispozicion në Zbatim të Vendimit Nr.29 datë 05.04.2017 për "Një shtesë dhe disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.84 datë 29.12.2016 për "Miratimin e programit buxhetor afat mesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017(i ndryshuar)" konfirmuar nga prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr.prot.1564/3 datë 20.04.2017.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **datë 20.10.2017 , ora 11:00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike nr.38 datë 25.09.2017**

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik "KEVIN KONSTRUKSION" shpk me nr. NUIS K71401004W
Vlera e ofertës pa TVSH = **86.367.731,81** (tetëdhjetë e gjashtë milion e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e një presje tetëdhjetë e një) **lekë.**

2. Operatori Ekonomik "ALB LEAA INTERNATIONAL" shpk, me nr. NUIS J86906408N
Vlera e ofertës pa TVSH = **110.990.000** (njëqind e dhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë) **lekë.**

3. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "PIENVIS" shpk & "MANE'S" shpk & "BE-IS" shpk me nr. NUIS K12410001Q, J64103865K, K71412003A
Vlera e ofertës pa TVSH = **112.614.279** (njëqind e dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e katërbëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë) **lekë.**

4. **Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "EVEREST" shpk & "SHANSI INVEST" shpk** me nr. NUIS J78311921L, J61924002T
Vlera e ofertës pa TVSH = **119.767.983** (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre) **lekë**.
5. **Operatori Ekonomik "KRONOS KONSTRUKSION" shpk** me nr. NUIS K41416033P
Vlera e ofertës pa TVSH = **122.185.257** (njëqind e njëzetë e dy milion e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e shtatë) **lekë**.
6. **Operatori Ekonomik "KACDEDJA" shpk** me nr. NUIS K51712017A
Vlera e ofertës pa TVSH = **122.454.035** (njëqind e njëzetë e dy milion e katërqind e pesëdhjetë e katër mijë e tridhjetë e pesë) **lekë**.

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm:

1- Operatori Ekonomik "KEVIN KONSTRUKSION" shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- *AK në Dokumentat Standarte te Tenderit në Kriteret e Veçanta ka kërkuar për realizimin e kontratës si më poshtë:*
 - *Një punësim mesatar i të paktën 100 (njëqind) personave, për periudhën Korrik 2016*
 - *Korrik 2017 të vërtetuar me;*

Shoqëria "KEVIN KONSTRUKSION" shpk në vërtetimin e paraqitur nga administrata tatimore me Nr.prot 16022 prot të datës 28.08.2017 për muajt janar 2017-Korrik 2017 si dhe në vërtetimin e paraqitur nga administrata tatimore me nr.prot 3432 të datës 14.02.2017 për muajt Korrik 2016-dhjetor 2016 si dhe në list pagesat për periudhën Korrik 2016-Korrik 2017 rezulton të ketë një numër mesatar prej 54 punonjësish.

Sa më sipër cituar për realizimin e punimeve në objektin "Rikonstruksion i pjesshëm i shkollës së mesme të përgjithshme "Andon Z. Çajupi" duhet të angazhojë 100 punonjës të kërkuar nga AK në dokumentat standarte të tenderit. Nga faktet e paraqitur më sipër del se shoqëria "KEVIN KONSTRUKSION" shpk ka të punësuar për periudhën Korrik 2016- KORRIK 2017 një numër mesatar prej 54 punonjësish,. Pra sa më sipër shoqëria "KEVIN KONSTRUKSION" shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 4/, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se:Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....b)Aftësia teknike;Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera

fizike, aftësitë organizative, reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

- Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik pika 5/1 si më poshtë cituar:

a. Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë për gjashtë muajt e fundit të pakten 31 (tridhjetë e nje) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta te jene te pakten:

- Grupi I- 7(shtate) punonjës
- Grupi II-10 (dhjetë) punonjës
- Grupi III- 9(nëntë) punonjës
- Grupi IV-3 (tre) punonjës
- Grupi V- 2 (dy) punonjës)
- (Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitet perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme)
- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 4 (kater) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda ng ate cilet dy automakiniste dhe dy eskavatoriste. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitet e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

Operatori Ekonomik “KEVIN KONSTRUKSION” shpk nuk ka paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri asnjë punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, që ti përkasë kategorive të mësipërme . Gjithashtu operatori Ekonomik nuk ka paraqitur asnjë punonjës manovrator në sistemin elektronik të app-së.

Pra sa më sipër shoqëria “KEVIN KONSTRUKSION” shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 4/, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....b)Aftësia teknike; Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

- Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik pika 5/2 si më poshtë cituar:

Te kete ne staf te punësuar:

5. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre dhe të figurojnë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë dhe në listpagesat e shoqërisë për periudhën Korrik 2016 - Korrik 2017, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, për inxhinierin e mjedisit operatorët ekonomik duhet të paraqesin dhe **Çertifikatën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**.

5.2 Inxhinier – Auditues energjie (1 person) (i pajisur me “Certifikate per auditimin e energjise)

5.3 (Per inxhinierin e eficenses se energjise duhet te kete keto dokumenta provues: Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit), Certifikata (Dip) per eficensen e energjise. Duhet të rezultojë në listpagesat e shoqërisë të paktën për 6 (gjashtë) muajt e fundit.)

Nga verifikimi në sistem I dokumentave të operatorit të mësipërm rezulton se ka paraqitur inxhinier mjedisi Zj. Me iniciale U.K por nuk ka paraqitur Certifikatën për Vlerësimin në Mjedis gjithashtu nuk ka paraqitur inxhinier-auditues energjie.

Për rrjedhojë dokumentacioni I shoqërisë lidhur me pikën ku kërkohet për inxhinierin e mjedisit operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dhe Certifikatën për Vlerësimin në Mjedis si dhe pika ku kërkohet inxhinieri auditues I energjisë është I paplotë rrjedhimisht I pasaktë.

- *Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik pika 12 si më poshtë cituar:*

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (shtojca 9)

| <i>Mjetet</i> | <i>Sasia</i> | <i>Gjendja</i> |
|---|--------------|---------------------|
| Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumii 10(dhjete) ton për secilin kamion) | 3 copë | Pronësi ose me qera |
| Fadrome me goma | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| MotoGjenerator | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Eskavator me goma 0.25 m3 | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Kamioçinë kapaciteti mbajtës për secilën kamioçinë deri në 2 ton | 3 copë | Pronësi ose me qera |
| Autobetoniere | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Mini eskavator | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Betonforma | 500 m2 | Pronësi ose me qera |
| Matrapik | 2 cope | Pronësi ose me qera |
| Vibrator | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 (tre pike pese) ton dhe maksimumi 5 (pese) ton per secilin kamion) | 4 cope | Pronësi ose me qera |
| Autopompe betoni | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Depozitë uji (5000) | 1 copë | Pronësi ose me qera |

| | | |
|--|---------|---------------------|
| Skela metalike (forme H) të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë me rrjetë mbrojtëse për punime në fasadë) | 1500 m2 | Pronësi ose me qera |
| Autobot uji | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Makineri per preje asfalti | 1copë | Pronësi ose me qera |

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 30 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 3 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 3 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet të shoqërohet me kontraten perkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- b) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c) *Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata perkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- d) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- f) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).*
- g) *(opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në datë 11.10.2017 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.*

Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë pranë Drejtorisë së Prokurimit Bashkia Tiranë.

- *Operatori ekonomik "KEVIN KONSTRUKSION shpk" ka deklaruar në shtojcën 9 eskavator me goma në pronësi për njërin eskavator ka paraqitur si dokumentacion plotësues fat zhdoganore 206 të datës 27.05.2003. Për mjetin e mësipërme nuk janë paraqitur certifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit,si dhe leja e qarkullimit*

rrugor mosplotësimi i këtij kushti bie në kundërshtim me “Kriteret e veçanta për kaulifikim”, kapaciteti Teknik pika 11, gërma (a) ku citohet:

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (lejë qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi

Pra sa më sipër cituar eskavatori me goma nuk ka lejën e qarkullimit, Çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracion mjeti. Gjithashtu AK në dokumentat e Tenderit kërkohet ti vendosen në dispozicion dy eskavatore me goma, operatori ekonomik ne shtojcën 9 të plotësuar nga ai vetë na ka paraqitur vetëm një eskavator për të cilin nuk ka dokumentacionin e nevojshëm.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 9, me pikën 12 është i paplotë , **për rrjedhojë i pavlefshëm**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2- Operatori Ekonomik “ALB LEAA INTERNATIONAL” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Bashkim Operatorësh Ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- *Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik pika 5/1 si më poshtë cituar:*

- b. Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë për gjashtë muajt e fundit të pakten 31 (tridhjetë e nje) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta te jene te pakten:

- Grupi I- 7(shtate) punonjës
- Grupi II-10 (dhjetë) punonjës
- **Grupi III- 9(nëntë) punonjës**
- **Grupi IV-3 (tre) punonjës**

- **Grupi V- 2 (dy) punonjës)**

- (Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmite perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme)

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 4 (kater) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda ng ate cilet dy automakiniste dhe dy eskavatoriste. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

Operatori Ekonomik “ALB LEAA INTERNATIONAL” shpk ka paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri 25 (njëzetë e pesë) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të të cilët nga 31 punonjës të kërkuar nga AK, në dokumentat Standarte të Tenderit . Punonjësit e paraqitur nga operatori ekonomik I mësipërm I përkasin grupit të parë dhe të dytë por nuk ka paraqitur asnjë punonjës të paisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik që ti përkasë grupit të III , të IV dhe të V-të . Gjithashtu operatori Ekonomik ka paraqitur dy punonjës manovrator në sistemin elektronik të app-së përkatësisht S. D manovrator eskavatorist dhe M.N manovrator automakinist ndërkohë që AK, në dokumentat Standarte të Tenderit **ka kërkuar katër manovratorë të mjeteve të rënda ng ate cilet dy automakiniste dhe dy eskavatoriste.**

*Pra sa më sipër shoqëria “ALB LEAA INTERNATIONAL shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket **personelit të nevojshëm** për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 4/, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, **duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....b)Aftësia teknike;Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative,.reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe **personelin e nevojshëm** për të zbatuar kontratën.***

- Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik pika 5/2 si më poshtë cituar:

Te kete ne staf te punësuar:

5. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te kenë në stafin e tyre dhe të figurojnë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë dhe në listpagesat e shoqërisë për periudhën Korrik 2016 - Korrik 2017, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, për inxhinierin e mjedisit operatorët ekonomik duhet të paraqesin dhe **Çertifikatën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.**

Nga verifikimi në sistem I dokumentave të operatorit të mësipërm rezulton se ka paraqitur inxhinier mjedisi Z. me initiale I.K por nuk ka paraqitur Certifikatën për Vlerësimin në Mjedis.

Për rrjedhojë dokumentacioni I shoqërisë lidhur me pikën ku kërkohet për inxhinierin e mjedisit operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dhe Certifikatën për Vlerësimin në Mjedis është I paplotë rrjedhimisht I pasaktë.

- Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik pika 12 si më poshtë cituar:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (shtojca 9)

| <i>Mjetet</i> | <i>Sasia</i> | <i>Gjendja</i> |
|--|--------------|---------------------|
| Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumii 10(dhjete) ton për secilin kamion | 3 copë | Pronësi ose me qera |
| Fadrome me goma | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| MotoGjenerator | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Eskavator me goma 0.25 m3 | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Kamioçinë kapaciteti mbajtës për secilën kamioçinë deri në 2 ton | 3 copë | Pronësi ose me qera |
| Autobetoniere | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Mini eskavator | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Betonforma | 500 m2 | Pronësi ose me qera |
| Matrapik | 2 cope | Pronësi ose me qera |
| Vibrator | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 (tre pike pese) ton dhe maksimumi 5 (pese) ton per secilin kamion | 4 cope | Pronësi ose me qera |
| Autopompe betoni | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Depozitë uji (5000) | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Skela metalike (forme H) të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë me rrjetë mbrojtëse për punime në fasadë) | 1500 m2 | Pronësi ose me qera |
| Autobot uji | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Makineri per preje asfalti | 1copë | Pronësi ose me qera |

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 30 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 3 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 3 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë

h) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë

periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

- i) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- j) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- k) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- l) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- m) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).
- n) (opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në date 11.10.2017 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.

Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni nje shkrese prane Drejtorise se Prokurimit Bashkia Tiranë.

Operatori Ekonomik "ALB LEAA INTERNATIONAL" shpk në përmbushje të kriterit të mësipërm kanë deklaruar në shtojcën nr.9 se disponon mjetet e mëposhtëme:

1. Kamion vetëshkarkues me targa AA228IO me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **13 Ton**
2. Kamion me targa AA161KI me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur **për këtë mjet 11.5 Ton**
3. Kamion Vetshkarkues AA094AH së bashku me kamion RTM AAR211 me targa me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **10 Ton dhe 13 Ton**
4. Kamion Vetshkarkues AA316IO së bashku me gjysëm rimorkion me targa ACR356 me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **11 Ton dhe 27 Ton**
5. Kamion Vetshkarkues AA789FI me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **5.9 Ton**
6. Kamion Vetshkarkues AA823JO së bashku me gjysëm rimorkion me targa ACR736 me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **12 Ton dhe 29 Ton**

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion tre kamiona vetëshkarkues me **kapaciteti mbajtës për secilën kamion minimum 5 Ton dhe maksimumi 10 ton** për ekzekutimin e kontratës. Nga sa më sipër rezulton se Operatori Ekonomik ka paraqitur në mënyrë të rregullt përsa I përket kapacitetit mbajtës vetëm dy kamiona vetëshkarkues dhe përkatësisht kamioni me targë AA094AH dhe kamioni me targë AA789FI .Kamionat e tjerë të mësipërme të

deklaruar nga bashkimi I operatorëve ekonomikë **kanë kapacitetin mbajtës mbi 10 ton për këtë fakt nuk do të konsiderohen të rregullta .**

*Operatori Ekonomik “ALB LEAA INTERNATIONAL” shpk në përmbushje të kriterit ku kërkohet si më poshtë **Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 (tre pike pese) ton dhe maksimumi 5 (pese) ton per secilin kamion 4 copë, nuk ka deklaruar në shtojcën nr.9 asnjë mjet me kapacitet mbajtës nga 3.5 ton deri në 5 ton:***

Gjithashtu Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihen në dispozicion tre kamionçina si më poshtë cituar “Kamionçinë kapaciteti mbajtës për secilën kamionçinë deri në 2 ton” për ekzekutimin e kontratës..Kamionçina e paraqitur në sistemin e app-së në shtojcën nr.9 me targë AA298HM ka kapacitet mbajtës 2.3 Ton . Gjithashtu operatori ekonomik ka deklaruar në shtojcën nr.9 kamionçinë me targë AA253OX dhe kamionçinë AA603 FT për të cilat **nuk ka paraqitur në dokumentacionin e hedhur në faqen e app-së asnjë dokument.**

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatorëve Ekonomik lidhur me shtojcën 9 , me pikën 12 është i paplotë , **për rrjedhojë i pavlefshëm**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3- Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “PIENVIS” shpk & “MANE’S” shpk & “BE-IS” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Bashkim Operatorësh Ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- ***Në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 12 citohet:***

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (shtojca 9)

| <i>Mjetet</i> | <i>Sasia</i> | <i>Gjendja</i> |
|----------------------------------|--------------|---------------------|
| | 3 copë | Pronësi ose me qera |
| Fadrome me goma | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| MotoGjenerator | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Eskavator me goma 0.25 m3 | 2 copë | Pronësi ose me qera |

| | | |
|---|---------|---------------------|
| Kamioçinë kapaciteti mbajtës për secilën kamionçinë deri në 2 ton | 3 copë | Pronësi ose me qera |
| Autobetoniere | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Mini eskavator | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Betonforma | 500 m2 | Pronësi ose me qera |
| Matrapik | 2 cope | Pronësi ose me qera |
| Vibrator | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 (tre pike pese) ton dhe maksimumi 5 (pese) ton per secilin kamion | 4 cope | Pronësi ose me qera |
| Autopompe betoni | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Depozitë uji (5000) | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Skela metalike (forme H) të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë me rrjetë mbrojtëse për punime në fasadë) | 1500 m2 | Pronësi ose me qera |
| Autobot uji | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Makineri per preje asfalti | 1 copë | Pronësi ose me qera |

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 30 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 3 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 3 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë

o) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

p) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

q) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

r) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

s) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

t) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).

u) (opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në date 11.10.2017 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të

gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.

Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë prane Drejtorise së Prokurimit Bashkia Tiranë.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion tre kamiona vetëshkarkues me **kapaciteti mbajtës për secilën kamion minimum 5 Ton dhe maksimumi 10 ton** për ekzekutimin e kontratës si dhe Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion katër kamiona vetëshkarkues me **kapaciteti mbajtës për secilën kamion minimum 3.5 Ton dhe maksimumi 5 ton** për ekzekutimin e kontratës

- *Kamion vetëshkarkues me targa AA736CU me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **6.7 Ton***
- *Kamion me targa AA917 HH me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **27 Ton***
- *Kamion Vetshkarkues KV 1998B me targa me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **6.3 Ton** i siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë me nr.2117Rep dhe nr.778kol të datës 23.05.2017 me afat vlefshmërie 1 vjeçar, afati i punimeve në kontratën objekt prokurimi është 10 muaj kalendarik . Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në pikën 12 gërma a në dokumentat standarte të tenderit si më poshtë cituar:
*Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet të shoqerohet me kontraten perkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për te gjithë periudhen e realizimit të kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
Kontrata për mjetin e mësipërm është e vlefshme për një afat 1 vjeçar nga data e lidhjes së saj që do të thotë është e vlefshme deri në datën **23.05.2018 pra nuk është e vlefshme për te gjithë periudhen e realizimit të kontrates objekt i ketij prokurimi. Nëse kontrata në fjalë do të nëshkruhet brenda muajit tetor 2017 atëherë afati i përfundimit të punimeve do të ishte muaji gusht 2018 pasi afati i kryerjes së punimeve është 10 muaj.****
- *Kamion Vetshkarkues AA324JU së bashku me gjysëm rimorkion me targa ACR710 me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **11.1 Ton dhe 29 Ton** i siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë me nr.2117Rep dhe nr.778kol të datës 23.05.2017 me afat vlefshmërie 1 vjeçar, afati i punimeve në kontratën objekt prokurimi është 10 muaj kalendarik . Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në pikën 12 gërma a në dokumentat standarte të tenderit si më poshtë cituar:
*Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet të shoqerohet me kontraten perkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për te gjithë periudhen e realizimit të kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
Kontrata për mjetin e mësipërm është e vlefshme për një afat 1 vjeçar nga data e lidhjes së saj që do të thotë është e vlefshme deri në datën **23.05.2018 pra nuk është e vlefshme për te gjithë periudhen e realizimit të kontrates objekt i ketij prokurimi. Nëse kontrata në fjalë do të nëshkruhet brenda muajit tetor 2017 atëherë afati i përfundimit të punimeve do të ishte muaji gusht 2018 pasi afati i kryerjes së punimeve është 10 muaj.****

- Kamion Vetshkarkues AA775NS me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **5.3 Ton**
- Kamion me vinç AA356SF me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **8.7 Ton**
- Kamion vetëshkarkues me targa TR9039I me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **3.2 Ton**
- Kamion me targa HS1345A me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur **për këtë mjet 2.2 Ton**
- Kamion me targa TR3811F me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur **për këtë mjet 2.4 Ton**

Nga sa më sipër rezulton se Bashkimi I Operatorëve Ekonomik ka paraqitur në mënyrë të rregullt përsa I përket kapacitetit mbajtës vetëm tre kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës nga 5 ton deri 10 ton secili kamion dhe përkatësisht kamionat me targë AA736CU dhe AA775NS si dhe kamionin me vinç AA356SF .

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar gjithashtu ti vihen në dispozicion katër kamiona vetëshkarkues me **kapaciteti mbajtës për secilën kamion minimum 3.5 Ton dhe maksimumi 5 ton** për ekzekutimin e kontratës. Nga sa më sipër rezulton se Bashkimi I Operatorëve Ekonomik nuk ka paraqitur asnjë kamion me kapacitet mbajtës nga 3.5 ton-5 ton .Kamionat e mësipërme të deklaruara nga bashkimi I operatorëve ekonomikë **kanë kapacitetin mbajtës poshtë 3.5 ton dhe kamionat e tjerë kanë kapacitet mbajtës mbi 10 ton për këtë fakt nuk do të konsiderohen të rregullta .**

Bashkimi i Operatorëve ekonomik të mësipërm kanë deklaruar në shtojcën 9 eskavatorë me goma copë 3 nga të cilët dy të siguruar me qera dhe një në pronësi si dhe kanë deklaruar një eskavator me zinxhir të siguruar me qera me kontratat përkatësisht me nr.857 rep dhe nr 373/I kol datë 08.05.2017 si dhe nr.6848/2665 datë 19.10.2017. Për të tre eskavatorët të siguruar me qera është paraqitur si dokumentacion shoqërues fatura doganore

Për mjetet e mësipërme nuk janë paraqitur çertifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit,si dhe leja e qarkullimit rrugor mosplotësimi i këtij kushti bie në kundërshtim me “Kriteret e veçanta për kaulifikim”, kapaciteti Teknik pika 12, gërma (a) ku citohet:

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (lejë qarkullimi), plus çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi

Pra sa më sipër cituar konsiderohet i rregullt vetëm eskavatori i deklaruar në shtojcën nr.9 nga shoqëria “MANE’S” shpk me targë AA537 NG i cili është i shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar.

Për eskavatorët e tjerë të deklaruar nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik duhet detyrimisht të kishin dokumentacionin shoqërues Lejë Qarkullimi, Çertifikatë e kontrollit teknik dhe siguracion mjeti. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi **dy eskavatorë me goma.**

Pra sa më sipër cituar eskavatorët me goma nuk ka lejën e qarkullimit, Çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracion mjeti.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik lidhur me shtojcën 9 , me pikën 12 përsa u përket kamionave me kapacitet mbajtës 3.5 ton -5 ton secili dhe paraqitjen e dy eskavatorëve me goma është i paplotë , **për rrjedhojë i pavlefshëm**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

4- Operatori Ekonomik “KRONOS KONSTRUKSION” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Bashkim Operatorësh Ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “**KRONOS KONSTRUKSION**” shpk ka paraqitur në sistemin elektronik Vërtetim Debie me Nr. 8160 Prot. datë 19.09.2017 sipas së cilës rezulton se nuk ka detyrime për faturat e energjisë elektrike deri në datën 18.09.2017 pa përfshirë faturën koherente të muajit Gusht 2017. Refruar Neni 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “*Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë*”, përcaktohet shprehimisht që: “*Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.*”
- Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit konkretisht muajin Gusht 2017.
- Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se Operatori ekonomik “**KRONOS KONSTRUKSION**” shpk, nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma “ç” të vendosur në DST, c’ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se “*Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e paguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.*”

Gjithashtu Operatori Ekonomik “KRONOS KONSTRUKSION” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion për të vërtetuar përmbushjen e kapacitetit financiar, teknik

Pra sa më sipër shoqëria “KRONOS KONSTRUKSION” shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem financiar, teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 4/, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme që AK i vlerëson të nevojshme..... b) Aftësia teknike; Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me kapacitetin ekonomik në pikat 1,2,3 dhe kapaciteti teknik në të gjithë pikat e kërkuara në Dokumentat Standarte të Tenderit /Kriteret e veçanta të Kualifikimitveta është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

5- Operatori Ekonomik “KACDEDJA” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Bashkim Operatorësh Ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Shoqëria “KACDEDJA” shpk në vërtetimin e paraqitur nga administrata tatimore me Nr.prot 6317/1 prot të datës 21.02.2017, nr.6317 datë 21.02.2017, nr.6317 datë 21.02.2017, nr 11353/1 ddatë 21.03.2017, nr.7030/2 datë 10.04.2017, nr. 27475/1 datë 23.05.2017, nr.33625/1 datë 15.06.2017, nr.46634/7 datë 25.09.2017, nr.37637/ 1 datë 19.07.2017 dhe nr.40387/1 datë 11.08.2017 për muajt Korrik 2016-Korrik 2017 si dhe në list pagesat për periudhën Korrik 2016-Korrik 2017 rezultoi të ketë një numër mesatar prej 55 punonjësish.

Sa më sipër cituar për realizimin e punimeve në objektin “Rikonstruksion i pjesshëm i shkollës së mesme të përgjithshme “Andon Z. Çajupi” duhet të angazhojë 100 punonjës të kërkuar nga AK në dokumentat standarte të tenderit. Nga faktet e paraqitur më sipër del se shoqëria “KACDEDJA” shpk ka të punësuar për periudhën Korrik 2016- KORRIK 2017 një numër mesatar prej 55 punonjësish,. Pra sa më sipër shoqëria “KACDEDJA” shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar

kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 4/, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, **duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....**b)Aftësia teknike; Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe **personelin e nevojshëm** për të zbatuar kontratën.

- Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik pika 5/1 si më poshtë cituar:

c. Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë për gjashtë muajt e fundit të pakten 31 (tridhjetë e nje) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta te jene te pakten:

- Grupi I- 7(shtate) punonjës
- Grupi II-10 (dhjetë) punonjës
- **Grupi III- 9(nëntë) punonjës**
- **Grupi IV-3 (tre) punonjës**
- **Grupi V- 2 (dy) punonjës)**
- (Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitet perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme)
- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 4 (kater) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda ng ate cilet dy automakiniste dhe dy eskavatoriste. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitet e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

Operatori Ekonomik “KACDEDJA” shpk ka paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, punonjës që I përkasin grupit të parë dhe të dytë për grupin e tretë nga 9 punonjës të kërkuar nga AK operatori ekonomik ka paraqitur 3 punonjës , për grupin e katërt nga tre punonjës të kërkuar operatori ekonomik ka paraqitur vetëm një punonjës dhe për grupin e pestë nga dy të kërkuar ka paraqitur vetëm një punonjës.

Pra sa më sipër shoqëria “KACDEDJA” shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket **personelit të nevojshëm** për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 4/, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, **duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme.....**b)Aftësia teknike; Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe **personelin e nevojshëm** për të zbatuar kontratën.

- *Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik pika 5/2 si më poshtë cituar:*

Te kete ne staf te punësuar:

5. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te kenë në stafin e tyre dhe të figurojnë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë dhe në listpagesat e shoqërisë për periudhën Korrik 2016 - Korrik 2017, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, për inxhinierin e mjedisit operatorët ekonomik duhet të paraqesin dhe **Çertifikatën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**.

Nga verifikimi në sistem I dokumentave të operatorit të mësipërm rezulton se ka paraqitur inxhinier mjedisi por nuk ka paraqitur Certifikatën për Vlerësimin në Mjedis.

Për rrjedhojë dokumentacioni i shoqërisë lidhur me pikën ku kërkohet për inxhinierin e mjedisit operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dhe Certifikatën për Vlerësimin në Mjedis është I paplotë rrjedhimisht i pasaktë.

- *Operatori ekonomik “KACDEDJA shpk” ka deklaruar në shtojcën 9 eskavator me zinxhir në pronësi për njërin eskavator ka paraqitur si dokumentacion plotësues fat zhdoganore të datës 27.04.2011. Për mjetin e mësipërme nuk janë paraqitur certifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit, si dhe leja e qarkullimit rrugor mosplotësimi i këtij kushti bie në kundërshtim me “Kriteret e veçanta për kualifikim”, kapaciteti Teknik pika 11, gërma (a) ku citohet:*

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (lejë qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi

Pra sa më sipër cituar eskavatori me goma nuk ka lejën e qarkullimit, Çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracion mjeti. Gjithashtu AK në dokumentat e Tenderit kërkohet ti vendosen në dispozicion dy eskavatore me goma, operatori ekonomik ne shtojcën 9 të plotësuar nga ai vetë na ka paraqitur dy eskavatorë një prej të cilëve me targa ACMT22 për të cilin ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm.

Në shtojcën nr.9 operatori ekonomik ka paraqitur vetëm një autobetonierë ndërkohë që në dokumentat e tenderit kërkohen dy autobetoniera për realizimin me sukses të kontratës.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 9, me pikën 12 është i paplotë , **për rrjedhojë i pavlefshëm**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Është kualifikuar si ofertë e suksesshme, ky ofertues :

- **Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "EVEREST" shpk & "SHANSI INVEST" shpk, kualifikohet në vend të parë.**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **119.767.983** (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre) lekë .

Çmimi total i ofertës me tvsh = **143.721.579** (njëqind e dyzetë e tre milion e shtatëqind e njëzetë e një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë.

Afati kohor për kryerjen e punimeve është brenda **10 (dhjetë) muajve** kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 23.10.2017

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se **Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë "EVEREST" shpk & "SHANSI INVEST" shpk, me adresë: Tiranë, Kamëz, Fabrika në Rrugën Nacionale, pranë Nyjes së Betonit , se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa TVSH **119.767.983** (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre) lekë, është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja "Dëshmorët e Kombit", nr.1, 1001, Tiranë, Sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.